

NJOFTIM PËR MEDIAN

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), i zgjedhur për të ushtruar veprimtarinë gjatë vitit 2020, zhvilloi mbledhjen e tij të parë, sot në datën 15.01.2020, me këtë rend dite:

- 1.Konstituimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me përbërjen e zgjedhur për të ushtruar funksionet dhe përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore për vitin kalendarik 2020.
- 2.Çështje të mbështetjes së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me mjete buxhetore, personel administrativ, ambiente dhe pajisje pune nga Gjykata e Lartë për vitin 2020.
- 3.Informacion për vendet vakante ekzistuese për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të cilat sipas Kushtetutës plotësohen nga Presidenti i Republikës, Kuvendi dhe Gjykata e Lartë.
- 4.Procedura e shortit për caktimin e anëtarëve relatorë për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për vendet vakante si më poshtë :

-Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Fatos Lulo.

-Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019 nga Presidenti i Republikës, për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj.

-Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 22.11.2019 nga Presidenti i Republikës për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi.

Në fillim të mbledhjes së KED, në lidhje me pikën e parë të rendit të ditës, u realizua konstituimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i zgjedhur me short nga Presidenti i Republikës, në datën 05.12.2019, **me këtë përbërje:**

- 1. Ardian Dvorani Kryetar**
- 2. Vitore Tusha Zëvendëskryetare**
- 3. Fiona Papajorgji Anëtare**
- 4. Arta Marku Anëtare**
- 5. Miranda Andoni Anëtare**
- 6. Saida Dollani Anëtare**
- 7. Ludovik Dodaj Anëtar**
- 8. Fatjona Memçaj Anëtare**
- 9. Arjan Qafa Anëtar**
- 1. Marsida Xhaferllari Anëtare Zëvendësuese**
- 2. Bilbil Mete Anëtar Zëvendësues**
- 3. Nazmi Troka Anëtar Zëvendësues**
- 4. Nezir Gjoka Anëtar Zëvendësues**

Në vijim të mbledhjes, në lidhje me pikat 2 dhe 3 të rendit të ditës, Këshill u njoh me mbështetjen administrative, buxhetore, burimet njerëzore në numër prej 10 specialistësh me funksione të ndryshme të caktuar nga Gjykata e Lartë si personel mbështetës me kohë të pjesshme për veprimtarinë e KED me qëllim përballimin e ngarkesës së punës së Këshillit gjatë vitit 2019. Duke vlerësuar angazhimin dhe ngarkesën e madhe të punës së përballuar gjatë vitit 2019, por edhe disa probleme që u shfaqën në këtë drejtim, Këshilli vlerësoi se ky personel është i pamjaftueshëm për të realizuar mbështetjen e plotë dhe efektive të veprimtarisë së KED për vitin 2020. Prandaj, nisur nga parashikimet kushtetuese dhe ligjore për realizimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve për së paku 6 vende vakante në Gjykatën Kushtetuese gjatë vitit 2020, u vlerësua nevoja për shtesë të menjëhershme të personelit mbështetës nga Gjykata e Lartë për Këshillin, me së paku 3 punonjës të tjerë administrativë, krahas vijimit të plotësisht të mëtejshëm të nevojave me buxhet të veprimtarisë së Këshillit.

Në lidhje me pikën e katërt të rendit të ditës, Këshilli realizoi procedurat e shortit për caktimin e anëtarëve relatorë për vendet vakante që janë aktualisht në proces shqyrtimi pranë KED. Pas organizimit të këtij shorti për caktimin e anëtarëve të Këshillit relatorë për vendet vakante, rezultatet janë si më poshtë vijon:

1. Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Fatos Lulo.

Relatore: Saida Dollani

2. Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019 nga Presidenti i Republikës, për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj.

Relatore: Arta Marku

3. Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 22.11.2019 nga Presidenti i Republikës për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi.

Relatore: Miranda Andoni

Gjithashtu, pas organizimit të shortit për caktimin e këshilltarëve të ngarkuar me mbështetjen e veprimeve të relatorëve për dy nga vendet vakante, rezultatet janë si më poshtë:

1. Këshilltar: Besmir Rrapaj

- për ndjekjen e veprimeve në mbështetje të *relatores* *Miranda Andoni* për procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave të kandidatëve Altin Binaj, Artan Spahiu dhe Gentian Mete, në vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 22.11.2019 nga Presidenti i Republikës për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi.

2. Këshilltar: Florjan Kalaja

- për ndjekjen e veprimeve në mbështetje të *relatores* *Miranda Andoni* për procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave të kandidatëve Eugen Papandile, Sonila Bejtja dhe Zhaklina Peto, në vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 22.11.2019 nga Presidenti i Republikës për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi.

3. Këshilltare Laureta Nezaj

- për ndjekjen e veprimeve në mbështetje të *relatores Arta Marku* për procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës së kandidatit Besnik Muçi, në vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019 nga Presidenti i Republikës, për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj

- për ndjekjen e veprimeve në mbështetje të *relatores Miranda Andoni* për procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave të kandidatëve Dedë Kasneci dhe Sergjio Mazreku, në vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 22.11.2019 nga Presidenti i Republikës për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi.

4. Këshilltar: Saimir Nazifi

- për ndjekjen e veprimeve në mbështetje të *relatores Miranda Andoni* për procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave të kandidatëve Sinan Tafaj dhe Shaqir Hasanaj, në vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 22.11.2019 nga Presidenti i Republikës për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi.



Zyra e Shtypit

Tel/Fax:04227806

<http://www.gjykataelarte.gov.al>